

VENDIM
Nr. 112/2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 92/2017, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, neneve 18, pika 1, dhe 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

I. Lidhja nr. 1, e vendimit të Kuvendit nr. 92, datë 29.9.2017, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, ndërsa efektet financiare të shtesës së numrit të punonjësve fillojnë nga data 1 janar 2025.

KRYETARE
Elisa SPIROPALI

Miratuar në datën 19.12.2024.

Lidhja nr. 1

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri
I. KRYETAR	G3*	(2) 1
Këshilltar pranë Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe Kryetarit	II-1	1
II. KOLEGJI I GJYQTARËVE		(6)
Gjyqtarë	G3*	6
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		(25)
Këshilltarë jurist	80% e pagës G3*	14
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	11
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	I-1	1
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN		(21)
Drejtor	I-4	1
Specialist sekretarie gjyqësore	IV-1	8
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-1	3

Përkthyes	II -1	7
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	II -1	1
Specialist pritje me popullin	IV-1	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(12)
Drejtore	I- 4	1
Specialist financë/buxhet	IV-1	1
Specialist i burimeve njerëzore	IV-1	1
Specialist IT**	IV-1	2
Specialist protokoll/arkiv***	IV-1	2
Magaziner	VI	1
Punonjës pastrimi	II	2
Shofer/korrier	V	1
Punonjës mirëmbajtje	III	1
Total		67

Shënim.

* Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

*** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

**** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.